



Duke u bazuar në nenin 43, 45 dhe 47 të Ligjit për Vetëqeverisje lokale, Nr.03/L-040, nenin 47 të Statutit të Komunës së Klinës Nr. 01-110-1232/2010. Nenin 5 të Udhëzimit Administrativ MAPL Nr.02-2015 për mbajtjen e mbledhjeve të kuvendit të komunës si dhe nenit 4 të Rregullores për Punë të Kuvendit dhe Komiteteve të Komunës, Kryesuesi i Kuvendit të Komunës bën këtë:

F T E S Ë

Ftohën të gjithë anëtarët e Kuvendit të Komunës së Klinës dhe të interesuarit e tjerë që të marrin pjesë në seancën e IV-të të rregullt të punës së kuvendit për vitin 2025.

Seanca mbahet më 25.04.2025 (e Premte), në sallën e Kuvendit të Komunës së Klinës dhe fillon në orën 10:00.

Lidhur me çështjen e mospjesëmarrjes në seancë, t'i referoheni dispozitës së nenit 39 të LVL-së. Për këtë seancë propozohet ky:

R E N D I I D I T Ë S:

1. Arsyetimi i mungesave,
2. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar,
3. Shqyrtimi dhe miratimi i Rekomandimeve të Komitetit për Politik dhe Financa,
4. Shqyrtimi i raportit të menaxhimit financiar janar-mars 2025 (ref.dejt.Fin.),
5. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për anulimin e vendimit 01Nr.06-3899/2025 për bartjen e mjeteve nga viti 2024 në vitin 2025 (ref. nga EKZ),
6. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për bartje të mjeteve të mbetura nga të hyrat vetanake të vitit 2024 në vitin 2025 (ref. nga EKZ),
7. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimeve të kryetarit të komunës për ndarje të mjeteve financiare sipas propozimeve 01Nr.06-8532/2025 dhe 01Nr.06-8705/2025 (ref. nga EKZ),
8. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimeve të DKA-së për ndarje të mjeteve financiare sipas propozimeve 01Nr.553-8606/2025 dhe 01Nr.553-8607/2025 (ref. nga DKA),
9. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit të DKRS-së për ndarje të mjeteve financiare sipas propozimit 01Nr.644-8473/25 (ref. nga DKRS),
10. Shqyrtimi i raportit të monitorimit të HZK-së – 2020-2028 (ref. nga DUMM),
11. Pyetje dhe përgjigjeje,

01Nr. 06-10593 2025
Klinë, me 15.04 2025



Kryesuesi i Kuvendit,
Fadil Gashi



Na osnovu člana 43, 45. i 47. Zakona o lokalnoj samoupravi, br. 03/L-040, člana 47. Statuta opštine Klina br. 01-110-1232/2010. Član 5 Administrativnog uputstva MAPL br. 02-2015 za održavanje sednica skupštine opštine kao i član 4 Pravilnika o radu Skupštine i opštinskih komisija, predsedavajući Skupštine Opštine, vrši sledeće:

OBAVEŠTENJE

Pozivaju se svi članovi Skupštine Opštine Klina i ostali zainteresovani da učestvuju na 4 redovnu radnu sednicu Skupštine za 2025 godinu.

Sednica se održava 25.04.2025 (petak), u sali Skupštine opštine Klina sa početkom u 10 časova.

U vezi sa pitanjem neučešća na sednici, referisete se na odredbu člana 39. ZLS.

Za ovu sednicu predložen je ovaj:

DNEVNI RED:

1. Opravdanje izostanaka,
2. Razmatranje i usvajanje zapisnika sa prethodnog sastanka,
3. Razmatranje i usvajanje Preporuka Odbora za politiku i finansije,
4. Razmatranje izveštaja o finansijskom upravljanju januar–mart 2025. godine (ref. dir. za finansije),
5. Razmatranje i usvajanje predloga-odluke o poništenju odluke broj 01Nr.06-3899/2025 o prenosu sredstava iz 2024. godine u 2025. godinu (ref. od EKZ),
6. Razmatranje i usvajanje predloga-odluke o prenosu preostalih sredstava iz sopstvenih prihoda iz 2024. godine u 2025. godinu (ref. od EKZ),
7. Razmatranje i usvajanje predloga-odluke predsednika opštine o raspodeli finansijskih sredstava prema predlozima 01Nr.06-8532/2025 i 01Nr.06-8705/2025 (ref. od EKZ),
8. Razmatranje i usvajanje predloga-odluke DKA o raspodeli finansijskih sredstava prema predlozima 01Nr.553-8606/2025 i 01Nr.553-8607/2025 (ref. od DKA),
9. Razmatranje i usvajanje predloga-odluke DKRS-a o raspodeli finansijskih sredstava prema predlogu 01Nr.644-8473/25 (ref. od DKRS),
10. Razmatranje izveštaja o monitoringu HZK-a – 2020–2028 (ref. od DUMM),
11. Pitanja i odgovori.

01Br. 06-10593 2025
Klina, 15.09 2025



Predsedavajući Skupštine
Fadil Gashi



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVO

www.komuna-klina.org

Një
U.
Organi

KOMUNA E KLINËS
MUNICIPALITY OF KLINA
OPŠTINA KLINA



Int
ost

26.03.2025

01-644-8473/25

Për:	Kuvendin Komunal, Kryesuesin e kuvendit z.Fadil Gashi Komitetit për politikë dhe financa
Nga:	Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport në Klinë, Drejtor: Driton Bardheci
Lënda:	Kërkesë
Datë:	26.03.2025
Vendi:	Klinë

I nderuar kryesues z. Fadil Gashi

Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit kërkon nga ju që në seancën e rregullt të Kuvendit Komunal në muajin prill, të vendoset pikë diskutimi dhe në votim ndarja e mjeteve buxhetore nga kategoria e subvencioneve në DKRS, për festivalin "I Këndojmë Lirisë" edicioni i 23-të, në vlerë prej 30.000 € (tridhjetë mijë euro).

Me respekt!





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVO

www.komuna-kline.org

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIC OF KOSOVO / REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA KLINË
MUNICIPALITY OF KLINA

KOMUNA E KLINËS
MUNICIPALITY OF KLINA

Data-Data

28.03.2025

Për/To/Za :	Komitetin për Politikë dhe Financa
Nga/From/Od :	Drejtoria për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim - z. Enver Berisha
Përmes/Through/Preko :	z. Zenun Elezaj – Kryetar i KK- Klinë
Tema/Subjekt/Subjekat:	Kërkesë për bartje të mjeteve të mbetura nga të hyrat vetanake të vitit 2024 në vitin 2025
Data :	28.03.2025

Të nderuar,

Duke u bazuar në Ligjin nr. 08/L-332 MBI NDARJET BUXHETORE PËR BUXHETIN E REPUBLIKËS SË KOSOVËS PËR VITIN 2025 , kërkojmë bartjen e mjeteve të pashpenzuara dhe mjetet nga tejkalimi i planit të të hyrave vetanake për vitin 2024, dhe bartjen në vitin 2025, gjithsej shumën prej 624,854.99 €.

Nga shuma e përgjithshme 624,854.99 €, nga fondi 21 dhe 22 është shuma prej 293,727.28 € dhe nga tejkalimi i planifikimit të të hyrave shuma prej 331,127.71 €. Sipas udhëzimeve të Ministrisë së Financave Ligjit të buxhetit për vitin 2025 dhe Ligjit të Menaxhimit të Financave Publike dhe Përgjegjësitë, nga teprica e mjeteve nga viti paraprak që barten në vitin vijues paguhen obligimet nga viti paraprak sipas kontratave të nënshkruara. Nisur nga kjo propozimi ynë për shpërndarjen e tyre nëpër programet dhe nën-programet buxhetore dhe kategoritë ekonomike të shpenzimeve, është si vijon:

- Mallra dhe Shërbime në shumën prej 90,000.00 €;
- Shpenzimet komunale në shumën prej 90,000.00 €;
- Subvencione dhe transfere shumën prej 92,746.95 €.
- Shpenzime kapitale në shumën prej 352,108.04 €;

Në kategorinë mallra dhe shërbime :

Arsimi Parafillor (92550), shuma prej 7,619.50 €;

Arsimi Mesëm (94710), shuma prej 11,936.30 €;

Administrata (16318), shuma prej 5,000.00 €;

Shërbimet kulturore (85018), shuma prej 8,000.00 €;

Buxhetimi (17518), shuma prej 57,444.2 €;

Në kategorinë e shpenzimeve komunale :

Drejtoria për Buxhet e Financa (17518), shuma prej 50,000.00 €;

Administrata e arsimit (92090) shuma prej 40,000.00 €.

Në kategorinë e subvencioneve dhe transfereve

Zyra e Kryetarit (16018) shuma prej 20,000.00€;

Administrata e arsimit (92090) shuma prej 2,800.00 €;

Shërbimet kulturore (85018), shuma prej 69,946.95 €.

Në kategorinë e shpenzimeve kapitale:

Planifikimi urban dhe inspeksion (66395), në projektet:

“Ndertimi i infrastruktures nentoksore dhe mbitoksore ne Siqueve-Ujmire-Shtarice”, kodi (54924), shuma prej 20,000.00 €;

“Ndertimi i infrastruktures nentoksore dhe mbitoksore ne Poterq-Dugajeve-Drenoc”, kodi (54344), shuma prej 25,000.00 €;

“Ndërtimi i infrastruktures nëntokësore dhe mbitokësore në Klinë, rrugën Martirët e Pastaselit, Martirët e Kralanit etj”, kodi (56059) shuma prej 20,000.00 €;

“Ndërtimi i infrastruktures nëntokësore dhe mbitokësore në Klinë, rrugën Martirët e Pastaselit, Martirët e Kralanit etj”, kodi (56063), shuma prej 20,000.00 €;

“Ndertimi i infrastruktures mbitoksore(Trotuare) dhe infrastruktutes nentokesore ne Zajm-Deiq”, kodi (56074), shuma prej 15,000.00 €;

“Ndertimi i infrastruktures mbitokesore dhe infrastruktures nentokesore Volljake-Sferke-Qupeve-Dush”, kodi (56084), shuma prej 15,000.00 €;

“Ndertimi i infrastruktures mbitokesore dhe infrastruktutes nentokesore Gjurgjevik i madh-Dush”, kodi (56094), shuma prej 25,000.00 €;

“Ndertimi i infrastruktures mbitokesore dhe nentokesore ne Jashanice-Jelloc-Resnik”, kodi (56106), shuma prej 21,000.00 €.

Bujqësi (47018), në projektet:

“Ndërtimi i kanaleve te ujitjes në Rudicë-Stupë-Videjë- Zajm,Potërq-Dollovë, Volljakë-Këpuz etj”, kodi (56152), shuma prej 44,698.91 €.

Infrastruktura Rrugore (18018), në projektet:

“Rindertimi i infrastruktures mbitokesore me asfalt ne Jashanice,Shtupel,Zllakuqan,Kline-Videje etj”, kodi (56126), shuma prej 50,000.00 €;

Shërbimet e shëndetësisë primare (74050), në projektet:

“Ndertimi dhe rindertimi I objekteve shendetesore: QKMF, AMF Drenoc, Ujmire, Zllakuqan dhe Gllareve etj”, kodi (56149), shuma prej 150.00 €.

Shërbimet Rezidenciale (75587), në projektet:

“Ndertimi i shtepise se pleqeve ne Kline”, kodi (54463), shuma prej 15,000.00 €.

Administrata (16318), në projektet:

“Blerja e veturave zyrtare per nevoja te Administrates Komunale”, kodi (54370), shuma prej 22,290.00 €

Shërbimet Kulturore (85018), në projektet:

“Ndertimi dhe Rindertimi i Objektit Sportiv dhe te Kultures ne Kline”, kodi (56154), shuma prej 38,969.13 €

Arsim dhe Shkencë - Administrata (92090), në projektet:

“Ndertimi i nxemjeve qendrore me pompa termike dhe nxemje me kaldaja me pellet ne shkolla në Gjinnazin Luigj Gurakuqi, Gremnik, Këpuz, Zllakuqan, Gjurgjevik I Madh, Budisalc, Ujmirë, Dren (56137), shuma prej 10,000.00 €;

“Ndërtimi I fushave sportive dhe parkingjeve në shkolla në Grabanicë, Siquevë, Zllakuqan, Leskoc, Sferkë etj”, kodi (56147), shuma prej 10,000.00 €.



01 Nr. 351-7775/2025
Klinë, datë 28.03.2025



NGA:	Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit z.Enver Berisha
PËR:	Komitetin për Politik dhe Financa në Klinë
LËNDA:	Kërkesë për shqyrtimin e monitorimit të HZK-2020-2028

-Në mbështetje të nenit 42 pika 1 pika 2 dhe neni 43 pika 5 të UA_ 24/2015 të MMPHI dhe Ligji për Planifikim Hapësinor të Republikës së Kosovës me nr. 04/L-174 , Ligji për Ndërtim me nr.04/L-110.dhe Ligji i Procedurës Administrative.

- Kërkojmë nga Komiteti për Politikë dhe Financa në Klinë që të shqyrtohet raporti i monitorimit të Hartës Zonale të Klinës-2020-2028

Arsyetim:Drejtoria e Urbanizimit dhe Mbrojtjes se Mjedisit në bashkëpunim me drejtoritë sektoriale të Komunës duke u bazuar në bazen ligjore të sipër përmendur ka formuluar raportin e vlerësimit të monitorimit te HZK-së 2020-2028 dokument i cili është i nevojshëm dhe i domosdoshëm për revidimin e këtij dokumenti, andaj kërkojmë nga KPF të vendoset në rend dite që të shqyrtohet në seancën e muajit Prill.

Materiali i këtij raporti do të dorëzohet në zyrën e kuvendit me kohë në formën fizike dhe elektronike.

Me respekt.



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINËS
MUNICIPALITY OF KLINA
OPŠTINA KLINA



www.komuna-kline.org

DREJTORIA E FINANCAVE, EKONOMISË DHE ZHVILLIMIT

01-Nr. 451-8739 2025

Klinë më dt: 28.03 2025

PËR: Komitetin për Politikë dhe Financa.

PËRMES: Kryetarit të Komunës z. Zenun Elezaj,

NGA : Drejtori i Drejtorisë Për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim z. Enver Berisha.

LËNDA: Kërkesë për hyrjen në rendin e ditës shqyrtimi i Raportit Financiar janar-mars 2025

Kërkojmë që të na mundësohet hyrja në rendin e ditës shqyrtimi i Raportit Financiar janar-mars 2025.

Duke u bazuar se ne SIMFK ende nuk është mbyll periudha e muajit mars 2025 materialin (Raportin Financiar janar-mars 2025) ju dërgojmë para datës së mbledhjes së KPF-së

Me respekt!



- PËR:** Komitetin për Politike dhe Financa, kryesuesin, **z. Fadil Gashi**;
Shërbimin për punë të Kuvendit, udhëheqësin, **z. Ahmet Berisha**;
- NGA:** Kryetari i Komunës së Klinës, **z. Zenun Elezaj**;
- LIDHJA:** Kërkesa e Këshillit të Bashkësisë Islame në Klinë, nr.01-345-7832/2025 e datës 19.03.2025;
- LËNDA:** Kërkesë për financim të një veture për Bashkësinë Islame në Klinë;



I nderuar kryesues,
Të nderuar anëtarë të KPF-së,

Më datën 19.03.2025 kam pranuar një kërkesë nga ana e Këshillit të Bashkësisë Islame të Kosovës Dega në Klinë, për financimin e blerjes së një veture për nevojat e BIK në Klinë, për lehtësimin e shërbimeve për qytetaret e Komunës së Klinës.

Andaj mbi bazën e kërkesës se lartpërmendur me ane të kësaj shkrese kërkojmë nga Komiteti për Politikë dhe Financa që të shqyrtoj mundësitë financiare për financimin e një veture, si dhe t'i rekomandoj Kuvendit të Komunës marrjen e vendimit për ndarjen e mjeteve financiare për blerjen e një veture për nevojat e BIK-ut në Klinë.

SHTOJCË: Bashkëngjitur gjeni kërkesën e BIK-ut, nr.01-345-7832/2025 të datës 19.03.2025.

Me respekt,

01Nr. 06-8532 /2025
Klinë, datë 27/03/2025

REPUBLIKA E KOSOVES

19.03.2025

Nje
U
Organ...

01. 345-783275



KËSHILLI I BASHKESISË ISLAME

Nr:07/25

Më:17.03.2025

KLINË

Për: Zyren e Kryetarit të Komunës z. Zenun Elezaj

Nga: Këshilli i Bashkësisë Islame Klinë

Lënda: Kërkesë për blerjen e një Veture për transport Kufoma.

Këshilli i Bashkësisë Islame në Klinë i drejtohet më kërkesë zyrës së Kryetarit të Komunes së Klinae z. Zenun Elezaj për blerjen e një veture që do te sigurate transportin e Kufomave dhe do të lehtësonte shërbimet fetare per Qytetarët e Komunës sonë.

Qmimi i blerjes së veturës arrin vleren 15.000 €.

Shpresojmë së kërkesa jonë do të hasë në mirekuptimin tuaj, Ju faleminderit.



KRYETARI

z.Kadri Berisha



PËR: Komitetin për Politike dhe Financa, kryesuesin, **z. Fadil Gashi**;
Shërbimin për punë të Kuvendit, udhëheqësin, **z. Ahmet Berisha**;

NGA: Kryetari i Komunës së Klinës, **z. Zenun Elezaj**;

LËNDA: Kërkesë për mbështetje të Stacionit Policor në Klinë;



I nderuar kryesues,
Të nderuar anëtarë të KPF-së,

Duke marre parasysh bashkëpunimin e mire të Komunës së Klinës dhe Stacionit Policor në Klinë, shprehim gatishmërinë e mbështetjes në përmirësimin e kushteve sipas nevojave të Stacionit Policor në Klinë.

Me ane të kësaj shkrese i drejtohem Komitetit për Politike dhe Financa më kërkesën që të shqyrtoj mundësitë financiare dhe t'i propozoj Kuvendit të Komunës së Klinës ndarjen e shumës prej 11,000.00 € (Njëmbëdhjetë mijë euro), më qellim të plotësimit të nevojave dhe krijimit të kushteve më të mira të Policisë së Kosovës përkatësisht Stacionit Policor në Klinë.

Me respekt,

01Nr. 06-8405 /2025
Klinë, datë 28/03 /2025



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINËS
MUNICIPALITY OF KLINA
OPŠTINA KLINA



www.komuna-klina.org

Drejtoria për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim

REPUBLICA KOSOVA			
Komuna e Klinës			
Pranësimi në			
04.04.2025			
Njësia org. Unit Organ. Jed.	Plani Plan Plan	Sl. Nr. Sl. Nr. Sl. Nr.	Vlera Amount Inost
01-052-9383/25			

RAPORT I MENAXHIMIT FINANCIAR I KOMUNËS SË KLINËS PËR PERIUDHËN JANAR-MARS 2025

RAPORTI ËSHTË PËRGATITUR BAZUAR NË LIGJIN NR. 03/L-048, MBI MENAXHIMIN E FINANCAVE
PUBLIKE DHE PËRGJEGJËSITË

1. Hyrje	3
1.1. Granti Qeveritar	3
1.2. Granti i të hyrave vetanake	3
1.3. Të hyrat vetanake të bartura	3
1.4. Performanca e shpenzimeve	4
2. Të hyrat buxhetore të komunës së Klinës për vitin 2025 duke i përfshirë edhe të hyrat nga donatorët sipas burimit të financimit	5
3. Të hyrat vetanake (sipas llojeve) të realizuara për periudhën janar-mars 2025 dhe krahasimi me periudhën e njëjtë të vitit paraprak	6
3.1. Realizimi i të hyrave për periudhën janar-mars 2025 sipas muajve	8
4. Shpenzimet buxhetore për periudhën janar-mars 2025 dhe krahasimi me vitin paraprak	9
4.1. Shpenzimet e buxhetit në periudhën janar-mars 2025 sipas kategorive ekonomike	10
5. Shpenzimet buxhetore për periudhën janar-mars 2025 - raportit të shpenzimeve analitike sipas kodeve buxhetore në SIMFK	12

1. Hyrje

Raporti për periudhën Janar-Mars 2025 është përgatitur në pajtim me dispozitat e nenit 45, paragrafët 45.2, 45.4 dhe 46.1 të Ligjit nr. 03/L – 048, për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë. Raporti i përgatitur paraqet buxhetin në SIMFK, shpenzimet dhe arkëtimin e të hyrave .

Raport financiar për buxhetin, të hyrat dhe shpenzimet për periudhën Janar – Mars 2025 është punuar për të analizuar realizimin e buxhetit në periudhën Janar – Mars 2025 do të japim një pasqyrë të buxhetit, të hyrave dhe shpenzimeve buxhetore, do të analizojmë disa trende të këtyre kategorive buxhetore si dhe do të bëjmë disa krahasime me parametrat buxhetor për këtë periudhë dhe disa krahasime me periudhën e njëjtë të vitit paraprak.

Buxheti sipas SIMFK për vitin 2025 duke përfshirë edhe të hyrat nga grantet e brendshme dhe te jashtme është 16,238,141.93 €, buxheti për këtë periudhë është më i lart për 10.33% se buxheti i vitit 2024.

Gjithsej pagesat kanë shënuar rritje prej 47.37% krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak, ku kontributin më të madh në këtë rritje gjatë kësaj periudhe e ka dhënë kategoria e shpenzimeve kapitale dhe kategoria e subvencioneve dhe transfereve.

1.1 Granti Qeveritar

Granti Qeveritar është burimi kryesor i financimit të buxhetit komunal, ku pjesëmarrja është 90.36% në periudhën janar-mars 2025 (shuma 14,673,149.00 €). Në raport me vitin paraprak buxheti nga GQ është 11.06% më i lart.

1.2 Granti I të hyrave vetanake

Të hyrat vetanake të komunës gjatë tremujorit të parë, janë arkëtuar në vlerën e përgjithshme vjetore 20.41 %, ndërsa kanë shënuar rënie prej 2.65 % krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak.

Grumbullimi i të hyrave buxhetore gjatë këtij tremujori kanë arritur shumën prej 305,247.50 € (20.41 %) e buxhetit total në këtë periudhë, të hyrat tatimore dhe jotatimore kanë shënuar një rënie prej 2.65% që korrespondon me 25,955.22 € më pak në krahasuar me tremujorin e vitit paraprak.

1.3 Të hyrat vetanake të bartura

Buxheti nga THV të bartura të vitit 2024 gjatë periudhës Janar-Mars 2025 nuk është bartur në SIMFK

Përveç Grantit Qeveritar dhe THV si burime të rregullta të financimit, si burim të financimit në këtë periudhë kemi edhe donacionet e brendshme të bartura, participimet e qytetarëve dhe grante tjera siq janë :

- ❖ **Granti i donatorëve të brendshëm - Participimi i qytetarëve** në shumën prej 48,572.59 €, në raport me vitin paraprak buxheti nga ky grant është **0.38 %** (shuma 185.40€) më i ultë se në vitin paraprak, mjete këto të bartura nga viti 2024.
- ❖ **Grante tjera të jashtme - Donacion i jashtëm** në shumën prej 18,341.33 €, mjete këto të bartura nga viti 2024.

1.4 Performanca e shpenzimeve

Shpenzimet buxhetore në periudhën Janar-Mars 2025 në shumën prej 4,543,158.98 € krahasuar me shpenzimet për periudhën e njëjtë të vitit 2024 në shumën prej 3,082,783.27 € janë më të larta për 47.37 %. Ndikim në rritjen e shpenzimeve ka pasur kategoria e shpenzimeve kapitale (rritje në kryerjen e punëve), kategoria e shpenzimeve komunale (obligime të bartura nga viti 2024) dhe kategoria e subvencioneve dhe transfereve (pagesat e transportit të nxënësve, pagesat e obligimeve lindje dhe varrime dhe subvencionimi i bujqëve).

Buxheti i shpenzuar në periudhën Janar-Mars 2025 në shumën prej 4,543,158.98 € është 28.10 % e buxhetit në SIMFK krahasuar me shumën e përgjithshme të buxhetuar për vitin 2025. Nga Granti qeveritar janë shpenzuar 4,364,334.74€ (29.74 % në raport me buxhetin nga granti), nga të hyrat vetanake janë shpenzuar 167,022.24 € (11.17% në raport me buxhetin nga granti), nga donacionet e brendshme janë shpenzuar 11,802.00 € (24.30% në raport me buxhetin nga granti).


Ndërsa nga totali i buxhetit të shpenzuar në këtë periudhë në shumën prej 4,543,158.98 € nga granti qeveritar janë shpenzuar 96.06%, nga të hyrat vetanake 3.68% dhe nga donacionet e brendshme 0.269 %. Krahasuar me vitin 2024, shpenzimet për këtë periudhë janë më të larta për 47.37 %.

- ❖ **Shpenzimet për paga dhe medetje** gjatë këtij tremujori, shënuan shpenzimin prej 2,222,128.27 €, duke arritur kështu normën e ekzekutimit në 24.99 % krahasuar me vlerën e përgjithshme të buxhetuar për këtë kategori. Shpenzimet e pagave gjatë periudhës raportuese, paraqesin një rritje prej 11.12%, apo rreth 222,425.59 € më shumë krahasuar me shpenzimet e pagave në periudhën e njëjtë të vitit 2024. Ndikim në këtë rritje të shpenzimit ka pasur ndryshimi i koficientëve të pagave për 0.5 në njësi.
- ❖ **Shpenzimet në mallra dhe shërbime** kanë shënuar një rritje prej 5.77% krahasuar me vitin 2024. Gjatë kësaj periudhe shuma e këtyre shpenzimeve ka arritur në 450,778.51 €, kjo shumë korrespondon me 26.52% të buxhetit për këtë kategori. Shpenzimet e mallrave dhe shërbimeve gjatë periudhës raportuese, paraqesin një rritje prej 5.77%, apo rreth 24,578.09 € më shumë krahasuar me shpenzimet e mallrave dhe shërbimeve në periudhën e njëjtë të vitit 2024.
- ❖ **Shpenzimet në komunali**, kanë shënuar rritje prej 110.01% krahasuar me vitin 2024. Gjatë kësaj periudhe shuma e këtyre shpenzimeve ka arritur 190,897.18 €, kjo shumë korrespondon me 51.59% të buxhetit për këtë kategori. Shpenzimet e komunaleve gjatë periudhës raportuese paraqesin një rritje prej 110.01 %, apo rreth 99,996.11 € më shumë krahasuar me shpenzimet e komunaleve në periudhën e njëjtë të vitit 2024. Në këtë rritje të shpenzimeve ka ndikuar bartja e borgjeve të pa paguara të vitit 2024.
- ❖ **Shpenzimet në subvencione dhe transfere**, shënuan shumën prej 215,585.39 € gjatë këtij tremujori, duke arritur kështu normën e ekzekutimit në 26.95% krahasuar me vlerën e përgjithshme të buxhetuar për këtë kategori. Te subvencionet dhe transferet, gjatë periudhës raportuese paraqitet një rritje prej 94.28%, apo rreth 104,620.96 € më shumë krahasuar me subvencionet dhe transferet në periudhën e njëjtë të vitit 2024. . Në këtë rritje të shpenzimeve ka ndikuar sepse nga 1 janari i vitit 2025 transportin e nxënësve jemi obliguar të paguajmë nga kategoria e shpenzimeve Subvencione dhe Transfere dhe përmbarimi i mjeteve për obligimet e kontrates kolektive të arsimit (shuma 89,946.95 €).
- ❖ **Shpenzimet kapitale.** Shpenzimet kapitale arritën shumën prej 1,463,769.63 €, që është 33.22% krahasuar me vlerën e përgjithshme të buxhetuar për këtë kategori. Shpenzimet kapitale gjatë periudhës raportuese paraqesin një rritje prej 221.70 %, apo rreth 1,008,754.96 € më shumë në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit 2024. Në këtë rritje të shpenzimeve ka ndikuar kryerja e punëve të kontraktuara dhe përmbarimi i mjeteve për obligimet e kontrates kolektive të arsimit (shuma 176,833.95 €).

2. Të hyrat buxhetore të komunës së Klinës për vitin 2025 duke përfshirë edhe të hyrat nga donatorët sipas burimit të financimit

Burimi i mjeteve	Buxheti sipas SIMFK për vitin 2025	% në total	Buxheti sipas SIMFK për vitin 2024	Ndryshimi 2025/2024 në %
Granti qeveritar	14,673,149.00	90.36	13,212,457.00	11.06
Të hyrat vetanake 2025	1,495,504.00	9.21	1,436,260.00	4.12
Të hyrat e bartura	-	-	-	
31_Granti I donatorëve të brendshëm	48,572.59	0.30	48,757.99	(0.38)
32_Granti I donatorëve të jashtme	18,341.33	0.11	18,341.33	-
61_Granti I jashtëm (Performancës)	2,575.01	0.02	2,575.01	-
TOTALI	16,238,141.93	100.00	14,718,391.33	10.33

Tabela 1. Buxheti Janar-Mars 2025 sipas burimit të financimit




Grafiku 1. Buxheti në SIMFK sipas burimit

2. Të hyrat vetanake (sipas llojeve) të realizuara për periudhën janar-mars 2025 dhe krahasimi me periudhën e njëjtë të vitit paraprak

Nr.	Kodi ekonomik	LLOJET E TRANSAKSIONEVE	Tremujori	%	Tremujori	%	Krahasimi në %	Ndryshimi
			2024	Ne total	2025	Ne total	2025/2024	ne €
1	40110	TATIMI NË PRONË	97,545.74	29.45	92,867.97	30.42	-4.80	-4,677.77
2	50001	TAKSË REGJISTRIMI I AUTOMJETEVE	20,597.42	6.22	21,440.00	7.02	4.09	842.58
3	50009	TAKSË PËR LEJE NDËRTIMI	98,973.51	29.88	100,465.05	32.91	1.51	1,491.54
4	50013	ÇERTIFIKATAT E LINDJES	116.00	0.04	51.00	0.02	-56.03	-65.00
5	50014	ÇERTIFIKATAT E KURORIZIMIT	-	0.00	-	0.00	#DIV/0!	0.00
6	50015	ÇERTIFIKATAT E VDEKJES	382.00	0.12	143.00	0.05	-62.57	-239.00
7	50016	ÇERTIFIKATA TJERA	8,024.00	2.42	6,429.00	2.11	-19.88	-1,595.00
8	50017	TAKSË VERIF. DOK.TË NDRYSHME	1,760.00	0.53	2,029.00	0.66	15.28	269.00
9	50019	TAKSA ADMINISTRATIVE	1,113.10	0.34	877.20	0.29	-21.19	-235.90
10	50024	ÇERTIFIKATAT MJEKSORE	-	0.00	255.00	0.08	#DIV/0!	255.00
11	50026	TAKSË PË LEGALIZIM	2,964.37	0.90	2,132.54	0.70	-28.06	-831.83
12	50029	TAKSË PËR USHTRIM TE VEPRIMTARISË	20,682.00	6.24	9,700.00	3.18	-53.10	-10,982.00
13	50032	TAKSË PËR FLETË POSEDUESE	4,270.00	1.29	2,967.00	0.97	-30.52	-1,303.00
14	50103	LARGIMI DHE DEPONIMI I AUTOMJE	500.00	0.15	800.00	0.26	60.00	300.00
15	50104	GJOBAT NGA INSPEKTORIATI	4,480.00	1.35	1,297.20	0.42	-71.04	-3,182.80
16	50205	LIC.PRANIM TEKNIK TE LOKALIT	1,286.78	0.39	1,123.50	0.37	-12.69	-163.28
17	50401	SHITJA E SHERBIMEVE		0.00	-	0.00	#DIV/0!	0.00
18	50403	TE HYRAT NGA SHITJA E MALLRAVE	-	0.00	-	0.00	#DIV/0!	0.00
19	50405	SHFRYTEZIMI I PRONES PUBLIKE	2,182.68	0.66	5,007.70	1.64	129.43	2,825.02
20	50406	PRONA PUB.PER TREG.TE HAPUR	-	0.00	-	0.00	#DIV/0!	0.00
21	50407	QIRAJA VENDOSJA OBJEKT TREGTAR	1,639.00	0.49	441.00	0.14	-73.09	-1,198.00
22	50408	QIRAJA NGA OBJEKTET PUBLIKE	4,162.99	1.26	2,051.36	0.67	-50.72	-2,111.63
23	50409	PARTICIPIM - SHENDETSIA	8,282.50	2.50	9,806.00	3.21	18.39	1,523.50
24	50409	PARTICIPIM - QERDHJA	7,343.30	2.22	6,910.00	2.26	-5.90	-433.30
25	50409	PARTICIPIM - ARSIMI I MESEM	28,885.00	8.72	17,110.00	5.61	-40.77	-11,775.00
26	50409	PARTICIPIM NGA GJEODEZIA	-	0.00	59.00	0.02	#DIV/0!	59.00

27	50409	Donacion I jashtem	-	#DIV/0!	-	#DIV/0!	#DIV/0!	0.00
28	55600	Participim I qytetareve	-	#DIV/0!	12,001.98	#DIV/0!	#DIV/0!	12,001.98
29	50504	Kadaster & gjeodezi	16,012.33	4.83	9,283.00	3.04	-42.03	-6,729.33
		GJITHESEJT:	331,202.72		305,247.50		-7.84	-25,955.22

Tab.2. Të hyrat vetanake (sipas llojeve) të realizuara për periudhën janar-mars 2025 dhe krahasimi me periudhën e njëjtë të vitit paraprak




Grafiku 2. Të hyrat vetanake sipas viteve

Tabela 3.1. Realizimi I të hyrave vetanake për periudhën janar-mars 2025 sipas muajve

Nr.	KODI EKONOMIK	LLOJET E TRANSAKSIONEVE	Të hyrat janar 2025	Të hyrat shkurt 2025	Të hyrat mars 2025	Totali I të hyrave janar-mars 2025
1	40110	Tatimi ne prone	21,009.80	35,901.37	35,956.80	92867.97
2	50001	Taksa rrugore	7,775.00	5,850.00	7,815.00	21440.00
3	50009	Urbanizem	29,556.57	64,889.54	6,018.94	100465.05
4	50013	Çertifikatat e lindjes	20.00	27.00	4.00	51.00
5	50014	Çert. E kurorëzimit	-	-	-	0.00
6	50015	Çertifikatat e vdekjes	6.00	128.00	9.00	143.00
7	50016	Çertifikatat tjera	2,226.00	2,149.00	2,054.00	6429.00
8	50017	Te hyrat tjera	741.00	928.00	360.00	2029.00
9	50019	Taksa administrative	303.70	317.90	255.60	877.20
10	50024	Çertifikatat mjeksore	105.00	60.00	90.00	255.00
11	50026	Takë per legalizim	970.54	1,001.20	160.80	2132.54
12	50029	T.per usht.veprimtar.	3,320.00	1,580.00	4,800.00	9700.00
13	50032	Taksë per flet posed.	950.00	1,067.00	950.00	2967.00
14	50103	Marimanga	300.00	-	500.00	800.00
15	50104	Denimet mandatore	1,000.00	-	297.20	1297.20
16	50205	Komisioni inspektues	361.00	86.00	676.50	1123.50
17	50401	Shitja e sherbimeve	-	-	-	0.00
18	50403	Shitja e pasurise	-	-	-	0.00
19	50405	Shfryt.pron.publike	4,600.00	-	407.70	5007.70
20	50406	Qer. per treg te hapur	-	-	-	0.00
21	50407	Qeraja e lokaleve	91.00	250.00	100.00	441.00
22	50408	Qeraja per banim	816.72	730.82	503.82	2051.36
23	50409	Participim - shendetsi	3,630.00	3,410.00	2,766.00	9806.00
24	50409	Participim - qerdhja	2,374.00	2,223.00	2,313.00	6910.00
25	50409	Participim - shp. F.A.	1,470.00	14,053.00	1,587.00	17110.00
26	50409	Participim nga gjeod.	-	30.00	29.00	59.00
27	50409	Donacion I jashtem	-	-	-	0.00
28	55600	Participim I qytetareve	199.98	11,802.00	-	12001.98
29	50504	Kadaster & gjeodezi	3,082.00	3,106.00	3,095.00	9283.00
TOTALI			84,908.31	149,589.83	70,749.36	305,247.50

Tab.3. Të hyrat vetanake (sipas llojeve) të realizuara për periudhën janar-mars 2025 sipas muajve




Grafiku 3. Të hyrat sipas muajve

4. Shpenzimet buxhetore për periudhën janar-mars 2025 dhe krahasimi me vitin paraprak

Burimi i mjeteve	Buxheti sipas SIMFK për vitin 2025	% në total	Buxheti i shpenzuar Janar-Mars 2025	Progresi ndaj buxhetit në %	% në total e shpenzimeve Janar-Mars 2024	Buxheti i shpenzuar Janar-Mars 2024	Krahasimi i shpenz. 2025 me 2024 në %
Granti qeveritar	14,673,149.00	90.36	4,364,334.74	29.74	96.06	3,006,181.83	45.18
Të hyrat vetanake 2024	1,495,504.00	9.21	167,022.24	11.17	3.68	64,614.94	158.49
Të hyrat e bartura	-	-	0			.	
31_Granti I donatorëve të brendshëm	48,572.59	0.30	11802	24.30	0.26	11986.5	-1.54
32_Granti I donatorëve të jashtme	18,341.33	0.11	0	0.00			#DIV/0!
61_Granti I jashtëm (Performancës)	2,575.01	0.02	0.00	0.00			#DIV/0!
TOTALI	16,238,141.93	100.00	4,543,158.98		27.98	3,082,783.27	47.37

Tabela 4. Shpenzimet buxhetore Janar-Mars 2025 krahasur me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar




Grafiku 4. Shpenzimet buxhetore Janar-Mars 2025 krahasur me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar

4.1 Shpenzimet e buxhetit në periudhën janar-mars 2025 sipas kategorive ekonomike

Përshkrimi	Buxheti në SIMFK 2024	Shpenzimet janar-mars 2025	Progresi ndaj buxhetit në %	% në total e shpenz. janar-mars 2024	Shpenzimet janar-mars 2024	Krahasimi 2025 me 2024 në %
						në %
Paga dhe mëditje	8,892,032	2,222,128.27	24.99	48.91	1,999,702.68	11.12
Mallra dhe shërbime	1,700,000	450,778.51	26.52	9.92	426,200.42	5.77
Shërbime komunale	370,000	190,897.18	51.59	4.20	90,901.07	110.01
Subvencione dhe transf.	800,000	215,585.39	26.95	4.75	110,964.43	94.28
Kapitalet	4,406,621	1,463,769.63	33.22	32.22	455,014.67	221.70
TOTALI	16,168,653.00	4,543,158.98	28.10	100	3,082,783.27	47.37

Tabela 5. Shpenzimet buxhetore janar-mars 2025 sipas kategorive ekonomike

Shpenzimet Janar-Mars 2025 sipas kategorive ekonomike



Grafiku 4.1. Shpenzimet buxhetore në periudhën Janar – Mars 2025 sipas kategorive ekonomike

Nga buxheti i shpenzuar në periudhën janar – mars 2025 në shumën prej 4,543,158.98 €:

- Për paga dhe mëditje janë shpenzuar 2,222,128.27€ (24.99 % në raport me buxhetin e alokuar për paga)
- Për mallra e shërbime janë shpenzuar 450,778.51 € (26.52 % në raport me buxhetin e alokuar për mallra e shërbime)
- Për shërbime komunale janë shpenzuar 190,897.18€ (51.59% në raport me buxhetin e alokuar për shërbime komunale)
- Për subvencione janë shpenzuar 215,585.39 € (26.95% në raport me buxhetin e alokuar për subvencione) dhe
- Për shpenzime kapitale 1,463,769.63 € (33.22% në raport me buxhetin e alokuar për shpenzime kapitale).

Ndërsa nga totali i buxhetit të shpenzuar në këtë periudhë në shumën prej 4,543,158.98 €, për paga e mëditje janë 48.91 % e shpenzimeve, për mallra dhe shërbime 9.92 % e shpenzimeve, për shërbime komunale 4.20 % e shpenzimeve, për subvencione 4.75 % e shpenzimeve dhe për kapitale 32.22 % e shpenzimeve.

Shpenzimet në periudhën Janar-Mars 2025 në shumën prej 4,543,158.98 € krahasuar me shpenzimet për periudhën e njëjtë të vitit 2024 në shumën prej 3,082,783.27 € janë më të larta për 47.37 % . Shpenzimet për paga dhe mëditje krahasuar me vitin paraprak janë më të larta për 11.12%, shpenzimet për mallra dhe shërbime janë më të larta për 5.77%, shpenzimet për shërbime komunale janë më të larta për 110.01 %, shpenzimet për subvencione janë më të larta për 94.28 % dhe shpenzimet kapitale janë më të larta për 221.70 %.

5. Shpenzimet buxhetore për periudhën janar-mars 2025, raportit të shpenzimeve analitike sipas kodeve buxhetore në SIMFK

Nr.	Kodi ekonomik	Përshkrimi	Shpenzimet Janar-Mars /2025	Shpenzimet janar- mars /2024	Ndryshimi
1	11111	PAGAT NETO PERMES LISTAVE	1,703,488.15	1,523,665.75	179,822.40
2	11121	TATIMI NË TË ARDHURAT PERSONALE	116,026.85	116,428.47	(401.62)
3	11131	KONTRIBUTI PENSIONAL - PUNËTORI	105,412.34	94,985.24	10,427.10
4	11151	SINDIKATAT	4,497.89	3,763.35	734.54
5	11152	ODAT PROFESIONALE	4,070.38	3,451.44	618.94
6	11211	PËRVOJA E PUNËS	95,055.35	82,807.31	12,248.04
7	11311	KONTRIBUTI PENSIONAL - PUNËDHËNËSI	105,412.34	94,985.24	10,427.10
8	11411	SHTESA E VEÇANTË PËR TË ZGJEDHURIT	9,277.54	12,348.51	(3,070.97)
9	11416	SHTESA PËR VËLLIMIN E PUNËS	440.83	276.38	164.45
10	11418	SHTESA PËR NËPUNËSEN/IN E SISTEMIT SHËNDETËSOR	2,848.88	-	2,848.88
11	11431	KUJDESTARIA, PUNA GJATË NATËS & PUNA JASHTË ORARIT TË PUNËS	74,937.66	65,396.83	9,540.83
12	11611	SHTESAT TRANZITORE	660.06	1,594.16	(934.10)
	TOTALI: 11	RROGAT DHE PAGAT	2,222,128.27	1,999,702.68	222,425.59
13	13140	TRANSPORTI PËR UDHËTIME ZYRTARE JASHTË VENDIT	310.00	-	310.00
14	13141	PARA XHEPI/MËDITJET PËR UDHËTIME ZYRTARE JASHTË VENDIT	354.00		354.00
15	13143	SHPENZIMET E TJERA PËR UDHËTIMET ZYRTARE JASHTË VENDIT	7.00	-	7.00
16	13310	SHPENZ. PËR INTERNET	755.41	682.78	72.63
17	13320	SHPENZ.E TELEFONIT-VALA 900	3,927.50	1,937.22	1,990.28
18	13330	SHPENZIMET POSTARE	28.90	321.70	(292.80)
19	13430	SHËRBIME TË NDRYSHME SHËNDETSORE	37,568.80	34,777.90	2,790.90

20	13445	SHËRBIMET E VEÇANTA - KONSULENTË DHE KONTRAKTORË INDIVIDUAL	10,459.31	15,819.84	(5,360.53)
21	13450	SHËRBIME SHËTYPJE - JO MARKETING	4,273.20	1,030.67	3,242.53
22	13460	SHERB.KONTRAKTUESE TJERA	6,669.50	34,149.29	(27,479.79)
23	13470	SHERBIME TEKNIKE	3,894.89	12,994.96	(9,100.07)
24	13475	SIGURIMI FIZIK I OBJEKTEVE PUBLIKE	8,107.50	9,729.00	(1,621.50)
25	13480	SHPENZIMET PER ANETARESIM	5,774.40	5,774.40	-
26	13501	MOBILJE (ME PAK SE 1000 Euro)	848.00	6,716.00	(5,868.00)
27	13503	KOMPJUTERËT	-	5,590.00	(5,590.00)
28	13509	PAISJE TJERA<1000 EURO	-	360.00	(360.00)
29	13511	PAJISJET SPORTIVE	15,749.40	-	15,749.40
30	13610	FURNIZIME PER ZYRE	6,408.01	6,496.21	(88.20)
31	13611	FURNIZIMI ME DOKUMENTE BLLANKO	-	2,000.00	(2,000.00)
32	13620	FURNIZIM USHQIM&PIJE(JO DREKA)	26,842.40	5,323.93	21,518.47
33	13630	FURNIZIME MJEKSORE	26,098.50	34,337.59	(8,239.09)
34	13640	FURNIZIM PASTRIMI	3,806.15	1,706.80	2,099.35
35	13720	NAFT PER NGROHJE QENDRORE	8,016.30	3,994.09	4,022.21
36	13760	DRU	48,755.60	32,654.00	16,101.60
37	13780	DERIVATET PËR AUTOMJETE, GJENERATORË DHE MAKINERI	13,453.27	18,919.31	(5,466.04)
38	13810	AVANCË (PARADHËNIA) PËR PARA TË IMËTA	500.00	-	500.00
39	13820	AVANC PËR UDHËTIME ZYRTARE	2,552.80	-	2,552.80
40	13950	REGJ.SIGURIMI I AUTOMJETEVE	1,165.00	810.00	355.00
41	13951	REGJ.SIGURIMI I AUTOMJETEVE	2,000.46	1,998.16	2.30
42	13954	KONTROLLIMI TEKNIK I AUTOMJETEVE	240.00	90.00	150.00
43	14010	MIREMBAJTJA DHE RIPARIMI I AUTOMJETEVE	8,258.02	14,168.90	(5,910.88)
44	14022	MIRËMBAJTJA E NDËRTESAVE ADMINISTRATIVE DHE AFARISTE	14,941.80	11,474.52	3,467.28
45	14023	MIRËMBAJTJA E NDËRTESAVE ARSIMORE	47,400.82	39,141.65	8,259.17
46	14024	MIRËMBAJTJA OBJEKTEVE SHËNDETËSORE	17,654.54	13,535.90	4,118.64

47	14026	MIRËMBAJTJA E OBJEKTEVE SPORTIVE	1,853.00	-	1,853.00
48	14032	MIRMBAJTJA ERRUGEVE LOKALE	75,183.92	94,855.40	(19,671.48)
49	14040	MIRMB.TEKNO.INFORMATIVE	5,518.86	820.00	4,698.86
50	14050	MIRMB.PAISJEVE DHE MOBILEVE	39,602.21	9,155.60	30,446.61
51	14060	MIRËMBAJTJA RUTINOREMIRËMBAJTJA RUTINORE	-	2,288.00	(2,288.00)
52	14210	REKLAMAT DHE KONKURSET	-	850.00	(850.00)
53	14230	SHPENZIMET PËR INFORMIM PUBLIK	1,102.70	1,247.50	(144.80)
54	14310	KOMPENSIMI I PËRFAQËSIMIT BRENDA VENDIT	696.34	449.10	247.24
	TOTALI: 13	MALLRA DHE SHERBIME	450,778.51	426,200.42	24,578.09
55	13210	RRYMA	134,555.87	73,072.09	61,483.78
56	13220	UJI	14,716.92	3,706.41	11,010.51
57	13230	MBETURINAT	40,356.15	12,827.47	27,528.68
58	13250	SHPENZIMET TELEFONIKE	1,268.24	1,295.10	(26.86)
	TOTALI: 14	SHPENZIMET KOMUNALE	190,897.18	90,901.07	99,996.11
59	22202	TRANSFERET PËR PËRFITUES INDIVIDUAL TJERË	125,638.44	110,964.43	14,674.01
60	22300	VENDIMET GJYQËSORE	89,946.95	-	89,946.95
	TOTALI: 20	SUBVENCIONET DHE TRANSFERET	215,585.39	110,964.43	104,620.96
61	31110	NDËRTESAT E BANIMIT	164,800.20	-	164,800.20
62	31121	OBJEKTET ARSIMORE	11,895.58	2,995.00	8,900.58
63	31123	OBJEKTET KULTURORE	48,913.83	-	48,913.83
64	31126	RRETHOJAT	99,940.00		99,940.00
65	31230	NDERTIMI I RRUGEVE LOKALE	633,112.45	253,523.12	379,589.33
66	31240	TROTUARET	81,863.35	48,496.55	33,366.80
67	31250	RRJETET E KANALIZIMIT	50,820.28		50,820.28
68	31260	RRJETET E UJESJELLESIT	-	50,000.00	(50,000.00)
69	31510	PAJISJET E GJENERIMIT TË EN. ELEK.DHE NDRIÇIMIT PUBLIK	159,074.99	-	159,074.99
70	32110	SHTRETËRIT E LUMENJVE	-	100,000.00	(100,000.00)
71	32111	SISTEMET E UJITJES	30,000.00	-	30,000.00

72	32140	PARQET DHE HAPËSIRAT PUBLIKE	6,515.00		6,515.00
73	34000	PAGESAT SIPAS VENDIMEVE GJYQËSORE	176,833.95		176,833.95
	TOTALI: 30	PASURIT JO FINANCIARE	1,463,769.63	455,014.67	1,008,754.96
TOTALI I PERGJITHSHEM:11,13,14,20,30			4,543,158.98	3,082,783.27	1,460,375.71

Klinë, 4.04.2025

Zyrtarja Kryesore Financiare



Melihate Behramaj



PËR: KPF-në; kryesusin z.Fadil Gashi
Sherbimin për punë të kuvendit, udhëheqësi z.Ahmet Berisha

NGA: Drejtori i Drejtorisë së Arsimit ne Klinë, z. Qemaj Sejdija

LIDHJA: Kërkesa nr.04-553-8363/25 e dt. 25.03.2025 e parashtruar nga Tuana Camaj

LËNDA: **Mendim Profesional**, lidhur me kërkesën nr.04-553-8363/25 e dt. 25.03.2025 e parashtruar nga Tuana Camaj që ka të bëj me përkrahje financiare

Te nderuar,

Pas pranimit të kërkesës të parashtruar nga Tuana Camaj, kërkesa nr 04-553-8363/25 e që ka të bëj me përkrahje financiare lidhur me udhëtimin e nxënësës për pjesëmarrje në Olimpiaden e shkencave që mbahet në Barcelonë nga data:09.07.2025 deri me 15.07.2025.

Nxënësja Tuana Camaj, aktualisht i ndjekë mësimet në Gjimnazin "Luigj Gurakuqi" në Klinë, e cila deri me tani ka treguar një sër rezultatesh në gara të ndryshme Komunale, Shtetërore dhe me gjerë.

Andaj i propozoj Kuvendit Komunal që kërkesa në fjalë të aprovohet si e tillë, e të cilat mjete mund të paguhen nga buxheti i DKA -së kategoria e subvencioneve , kodi 10/634/92090/200/00000/980 në vlerën prej 1500 Euro.

Shtojcë: Bashkëngjitur gjeni kërkesën e palës , ftesën nga Qendra organizative (INFINITI), certifikaten e medaljes së argjend dhe konfirmimin e bankës.

Me respekt,

Nr. 553-8606 / 2025
Klinë, dt. 27/03/2025



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINËS
MUNICIPALITY OF KLINA
OPŠTINA KLINA



www.komuna-kline.org

PËR: KPF-në; kryesusin z.Fadil Gashi
Sherbimin për punë të kuvendit, udhëheqësi z.Ahmet Berisha

NGA: Drejtori i Drejtorisë së Arsimit ne Klinë, z. Qemajl Sejdiu

LIDHJA: Kërkesa nr.01-451-6539/25 e dt. 05.03.2025 e parashtruar nga Selim Bashota
(Prind)

LËNDA: **Mendim Profesional**, lidhur me kërkesën nr. 01-451-6539/25 e dt. 05.03.2025
e parashtruar nga Selim Bashota që ka të bëjë me përkrahje financiare

Te nderuar,

Pas pranimit të kërkesës të parashtruar nga Selim Bashota, kërkesa nr 01-451-6539/25 e që ka të bëjë me përkrahje financiare lidhur me udhëtimin e nxënëses **Klejda Bashota** në Gjermani për pjesëmarrje në Festivalim IFLC Gjermani, konsideroj se aprovimi i kësaj kërkesë është i natyrës së domosdoshme për faktin se nxënësjja në fjalë ka talent të shquar në muzikë (Këndim) dhe si e tillë me pjesëmarrje në një festival të tillë e perfaqëson jo vetem shkollën por edhe Komunën e Klinës.

Andaj i propozoj Kuvendit Komunal që kërkesa në fjalë të aprovohet si e tillë, e të cilat mjete mund të paguhen nga buxheti i DKA -së kategoria e subvencioneve , kodi 10/634/92090/200/00000/980 në vlerën prej 1500 Euro.

Shtojcë: Bashkngjitur gjeni kërkesën e palës , ftesën nga Gjermania, konfirmimin e bankës dhe leternjoftimin.

Me respekt,

Nr. 553-8607/2025
Klinë, dt. 27/03/2025